# DËSHMI ARKIVI

**A-462546**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Preç Zogaj: Vendimi i Hagës është betejë ligjore, kërkon konsensus të gjerë politik |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/23/prec-zogaj-vendimi-i-hages-eshte-beteje-ligjore-kerkon-konsensus-te-gjere-politik/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:48:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 06:36:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `faf09ce539d19742ec8ad97b5ed53e69f013c35ac799ac445ff267991a63b4b4` |
| TEKSTI | `9ccab3769ec11b6622d15d99013fa96d1f8d9d79af6e47e0fdcd3fb2d273be6e` |
| PAMJA | `e75d083ba5e7b9970a5815f162b5a1434f5f2db9b10c4e518df0e51f9b1d864c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c2f348ac088315beb0079dd96ffe29f62993d4fe470fcfee67654db793ec5ab8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c2f348ac088315beb0079dd96ffe29f62993d4fe470fcfee67654db793ec5ab8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Preç Zogaj: Vendimi i Hagës është betejë ligjore, kërkon konsensus të gjerë politik

Rajon

Publikuar: 23/09/2026



Analisti dhe publicisti Preç Zogaj, i ftuar në emisionin "Trialog" në RTSH-24 me moderatoren Alba Alishani, komentoi vendimin e Gjykatës së Hagës për ish-drejtuesit e UÇK-së, duke e cilësuar si një moment që kërkon përgjegjësi dhe konsensus politik.

"*Kjo që ka ndodhur në Kosovë është një ngjarje që apelon për konsensus të gjerë nga të gjitha palët, pra një konsensus që ne bashkohemi me një qëndrim të përbashkët, qoftë për të mbështetur këtë nismë ligjore që ka marrë në rastin konkret PDK, duke parë dhe konform legjislacionit. Nuk besoj se do të mbetet në një nismë me qëllime propagandistike, pra ajo duhet të jetë serioze,*" u shpreh Zogaj.

Ai shtoi se përtej debatit politik, çështja është e natyrës juridike dhe duhet trajtuar si e tillë.

"*Mua më duket se sot, madje edhe djali i Hashim Thaçit ka një gjë racionale; kjo është një betejë ligjore së pari. Politikanët në Kosovë, por edhe këtu në Shqipëri, duke transferuar problemet e tyre që kanë vetë me drejtësinë, i çojnë dhe në Kosovë.*"

Zogaj nuk e përjashtoi mundësinë e gabimeve në vendimet e gjykatës, por theksoi se sistemi i drejtësisë është i ndërtuar me shkallë që korrigjojnë njëra-tjetrën.

"Unë mund ta mendoj se gjykata ka gabuar në vendimin që ka dhënë apo e ka ekzagjeruar vendimin që ka dhënë. Ndaj sistemi i drejtësisë është i ndërtuar me shkallë, që një shkallë mund të gabojë dhe një shkallë tjetër eliminon gabimin e një shkalle tjetër. Pra betejat janë ligjore."


## Më të lexuarat


Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë euro / Para...


500 mesazhe / "Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te Gys Agasi p...


Besnike si 'çmendur' e Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tendera n...


Të gjithë e dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te autoritetet


Çifti Brunilda Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

TAG: Preç Zogaj

## Të ngjashme




**OVL-UÇK paralajmëron protesta në të gjithë Kosovën të premten**

**Haradinaj ngjitet në majën e Rupës, valëvit flamurin e UÇK-së**

**Mediat ruse e serbe e paraqesin protestën në Tiranë si “trazira” për shkak të dënimit të ish-krerëve të UÇK-së**

## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë




Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.